



**UNIVERSITETI**  
I SHKENCAVE TË APLIKUARA  
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 754/20; Datë: 02.03.2020

Në bazë të nenit 23 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2020, merr

**V E N D I M**

- I. Miratohet Dokumenti "Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Pergjithshme në UShAF".
- II. Dokumenti hynë në fuqi nga dita e miratimit të tij.

**A r s y e t i m**

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF, pas elaborimit të draft dokumentit në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet DALIPI



**UNIVERSITETI**  
I SHKENCAVE TË APLIKUARA  
FERIZAJ

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 754/20, Dt.: 02.03.2020

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET  
E PËRGJITHSHME NË USHAF**

Ferizaj, Mars, 2020

S.D.

Në mbështetje të nenit 23, pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm (në tekstin e mëtejme Statuti) të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e zgjedhjeve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 02.03.2020, miraton

## RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË USHAF

1. Dispozitat e përgjithshme;
2. Rregullat zgjedhore;
3. Lista e votuesve;
4. Kandidatët;
5. Regjistrimi i kandidatëve;
6. Komisioni Qendror Zgjedhor;
7. Komisioni Zgjedhor;
8. Dita e zgjedhjeve;
9. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet;
10. Rezultatet e zgjedhjeve - hedhja e shortit;
11. Periudha e ankesave.

### I. Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

1. Zgjedhjet e përgjithshme në UShAF shpallen nga Këshilli Drejtues.
2. Të gjitha rregullat dhe procedurat e mëtejme duhet t'i referohen dhe të bazohen në Statutin e UShAF, Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe akteve tjera normative në fuqi.
3. Çdo ankesë kundër vendimeve të bazuara në këto rregulla dhe procedura duhet të adresohet:
  - Së pari tek Komisioni Qendror Zgjedhor, dhe
  - Së dyti tek Këshilli Drejtues i UShAF.

#### Neni 2

Zgjedhjet si më poshtë do të mbahen në fakultetet e UShAF, sipas nenit 50 dhe 65 të Statutit:

1. Anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor të Universitetit nga radhët e personelit akademik;

J.D.

2. Anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor të Universitetit nga radhët e personelit jo - akademik;
3. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik;
4. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit jo - akademik;
5. Zgjedhja e Drejtorëve të Programit të studimeve;
6. Zgjedhja e perfaqësuesve të perkohshëm të drejtorëve të programit.

### Neni 3

Personeli akademik i UShAF-it përfshinë; grupet, siç ceket në nenin 138, pika 2 të Statutit:

1. Profesor i rregullt;
2. Profesor i asocuar;
3. Profesor asistent;
4. Ligjërues;
5. Asistent;
6. Lektor.

### Neni 4

1. Të gjithë mandatarët të cilët zgjedhen ligjshëm përmes këtyre zgjedhjeve, do të mbajnë mandatin e tyre për katër vite.
2. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, përjashtimit të mandatarit, apo për shkak të ndonjë arsye tjetër, mandati do t'i takoj personit të parë të pazgjedhur sipas rezultateve fillestare të zgjedhjeve, të dala nga votat e fituara.
3. Në rast kur nuk ka persona në dispozicion nga rezultatet fillestare të zgjedhjeve, mandatet do të mbeten të paushtruara deri në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme.

### Neni 5

1. Secili anëtar i personelit të UShAF -it me marrëdhënie të rregullt (primare), do të ketë të drejtë të marrë pjesë në këto zgjedhje.
2. Në mënyrë që të ketë të drejtë të radhitet si
  - Votues;
  - Kandidat.
3. Personeli, i cili nominohet për pozitën e anëtarit të Këshillit Mësimor/Shkencor

S. A.

dhe Senatit, duhet t'i zbatojë rregullat e cekura në vazhdim:

- Nenin 17.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që do të thotë se "Nëpunësit civil nuk mund të mbajnë pozita drejtuese në parti politike dhe të jenë aktiv politikisht".
- Në rastet e kontestueshme sipas pikës (2) të këtij neni në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi duhet të merret nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
- Për çdo vendim negativ arsyet duhet të jepen në formë të shkruar nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

## II. Rregullat zgjedhore

### Neni 6

Anëtarët e Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF nga radhët e personelit akademik, do të zgjedhen siç përcaktohet në nenin 138 pika 2 të Statutit të UShAF, profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, ligjërues, asistent dhe lektor.

### Neni 7

Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik do të zgjedhen nga personeli akademik i fakulteteve, siç përcaktohet në nenin 138 pika 2 të Statutit dhe përshkruhet në hollësi: profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, ligjërues, asistent dhe lektor.

### Neni 8

Një anëtar i personelit jo-akademik, do të zgjedhet si anëtar i Këshillit Mësimor/Shkencor të Universitetit.

### Neni 9

1. Një anëtar i Senatit nga radhët e personelit jo-akademik do të zgjedhet nga personeli jo-akademik i Universitetit, ashtu siç përcaktohet në Statut.
2. Në rast të votave të barabarta të kandidatëve për mandatin e anëtarit të Senatit nga personeli jo-akademik, përparësi do t'i jepet kandidatit të gjinisë femërore.

S. A.

### III. Listat e votuesve

#### Neni 10

1. Administrata e Universitetit ka për detyrë t'ia ofrojë të dhënat e kompletuara të votuesve me të drejtë vote Komisionit Qendror Zgjedhor.
2. Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga administrata e Universitetit, do të merren masa disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues, pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

#### Neni 11

Një listë me të drejtë vote do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin fakultet, duke përfshirë të dhënat si në vijim:

##### Personeli akademik:

- Numri rendor;
- Emri;
- Mbiemri;
- Data e lindjes;
- Numri personal;
- Grada shkencore – Titulli profesional;
- Fakulteti.

##### Personeli jo – akademik

- Numri rendor;
- Emri;
- Mbiemri;
- Data e lindjes;
- Numri personal;
- Pozita;
- Departamenti – Divizioni.

S.D.

#### IV. Kandidatët

##### Neni 12

1. Secili anëtar i personelit të UShAF-it që është regjistruar në listën e votuesve, ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për mandat, siç ceket në nenin 11 të Rregullores.
2. Të qenit anëtar në Komisionin Qendror Zgjedhor të Universitetit, ose në Komisionin Zgjedhor të Universitetit, nuk është pengesë për të qenë kandidat në zgjedhjet e përgjithshme.
3. Votuesit me të drejtë vote kanë të drejtë të regjistrohen për më shumë se një mandat.
4. Në qoftë se një anëtar i personelit zgjedhet në më shumë se një organ të Universitetit, pozita në Senat mbizotëron në krahasim me pozitën në Këshill Mësimor/Shkencor të Universitetit. Komisioni Qendror Zgjedhor i Universitetit e ka për obligim t'i sqarojë përsëritjet e tilla në emërime para shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.
5. Nuk lejohet ushtrimi i më shumë pozitave se në një organ të Universitetit. Nëse një anëtar i personelit shkelë mbi këtë parim, Komisioni Qendror Zgjedhor i Universitetit i revokon të gjitha mandatet e këtij personi. Procesi i zëvendësimit të mandateve, pastaj bëhet sipas mënyrës së përshkruar në pikën 4 të këtij neni.
6. Për pozitën dekan i fakultetit dhe rektor i UShAF-it, nuk mund të zgjedhën kandidatët të cilët pengohen që t'a ushtrojnë së paku gjysmën e mandatit për shkak të plotësimit të moshës mandatore të pensionit.

#### V. Regjistrimi i kandidatëve

##### Neni 13

1. Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për ndonjë mandat që i është caktuar kategorisë së tij/saj.
2. Duhet të përgatiten procedurat e regjistrimit për organet e Universitetit.
3. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të caktojë një periudhë për regjistrim prej orës 08:00 deri në 16:00 gjatë ditës së regjistrimit, datë e cila do të shpallet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
4. Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku 2 ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Votuesit me të drejtë vote, të cilët kanë pengesa për shkaqe objektive, apo subjektive, iu mundësohet pjesëmarrja në procedurat e regjistrimit përmes postës elektronike.

S.D.

6. Një formular përkatës për regjistrim, shtojca 1, do të jetë në dispozicion në Universitet.

#### Neni 14

1. Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturave për validitet, duke iu referuar ditës së votimit dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave.
2. Lista zyrtare e kandidatëve do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor, përfshirë të dhënat si në vijim:

##### Personeli akademik

- Numri rendor;
- Emri;
- Mbiemri;
- Data e lindjes;
- Numri personal;
- Grada shkencore – titulli profesional;
- Fakulteti.

##### Personeli jo-akademik

- Numri rendor;
- Emri;
- Mbiemri;
- Data e lindjes;
- Numri personal;
- Pozita;
- Departamenti - Divizioni.

3. Lista zyrtare e kandidatëve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor, dy (2) ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.

S.A.



## VI. Komisioni Qendror Zgjedhor

### Neni 15

1. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) do të përmbushë obligimet e veta, siç ceket në Statutin e Universitetit dhe aktet tjera ligjore.
2. Këshilli Drejtues i Universitetit themelon KQZ-në. KQZ parimisht përbëhet prej 3 profesor të Universitetit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe një anëtar nga administrata, një përfaqësuesi të MASHT-it në cilësi të monitoruesit pa të drejtë vote, si dhe një përfaqësues nga KQZ e Republikës së Kosovës në cilësi të monitoruesit pa të drejtë vote.
3. Sekretari i Përgjithshëm i UShAF-it, është kryetar i KQZ sipas detyrës zyrtare (ex officio).
4. Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar nga organizatat nominuese sipas paragrafit (2) të këtij neni që në ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kjo shkresë duhet t'iu dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Këshillit Drejtues, më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstitutiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave. Mbledhjen konstitutive e fillon kryetari i Këshillit Drejtues.

### Neni 16

Secili anëtar i personelit do të ketë të drejtë të ankohet kundër vendimeve të KQZ në formë të shkruar dhe me arsyetim të bazuar në Këshillin Drejtues të Universitetit. Vendimi rreth ankesës duhet të merret brenda 4 javësh pas pranimit. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar.

## VII. Komisioni Zgjedhor

### Neni 17

1. Komisioni Zgjedhor përbëhet nga 5 anëtarë nga stafi administrativ i UShAF të cilin e zgjedh Këshilli Drejtues me rastin e shpalljes së zgjedhjeve, kryesuesin, zëvendëskryesuesin dhe tre anëtarë.
2. Në rastet kur organizohen zgjedhjet studentore, Komisionit Zgjedhor i

S.D.

bashkëngjiten edhe dy anëtarë studentë në cilësinë e vëzhguesit nga dy organizata fituese me më shumë vota të fituara në zgjedhjet e fundit, por pa të drejtë vote.

3. Për mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve, caktohet staf mbështetës administrativ prej 3 zyrtarëve.
4. Protokolet e Komisionit Zgjedhor duhet të përgatiten dhe të nënshkruhen nga Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Komisionit Zgjedhor.
5. Mbledhjet e Komisionit Zgjedhor thirren nga Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor me pëlqimin e KQZ.

### **VIII. Dita e zgjedhjeve**

#### **Neni 18**

1. KQZ duhet të vendosë dhe të shpallë ditën e zgjedhjeve konform dinamikës së zgjedhjeve, të miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet të hapen nga ora 07:00 deri në ora 19:00.
3. Në rastë se votojnë të gjithë kandidatët e regjistruar në regjistrin votues dhe me konstatim të Komisionit Zgjedhor, vendvotimi mund të mbyllet edhe më herët.

#### **Neni 19**

1. Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në vendvotim në të cilin janë caktuar sipas regjistrit të kandidatëve me të drejtë vote.
2. Asnjë votues nuk duhet të ketë të drejtë të votojë në më shumë se në një vendvotim.

#### **Neni 20**

KQZ në bashkërendim me Komisionin Zgjedhor vendosë për lokacionin e vendvotimeve.

#### **Neni 21**

Zgjedhjet mbahen nga Komisioni Zgjedhor nën mbikqyrjen e KQZ.

### **IX. Procedura e votimit dhe fletëvotimet**

*N. D.*

## Neni 22

1. Gjatë kohës së votimit, së paku tre anëtarë të KQZ-së duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.
2. Komisioni Zgjedhor duhet të sigurojë hapat e mëtejme procedurale për mbarëvajtje të zgjedhjeve:
  - Hapja dhe mbyllja e vendvotimit në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimit hapur gjatë periudhës së caktuar të zgjedhjeve;
  - Ofrimi i materialeve të nevojshme për mbajten e votimeve;
  - Shpërndarja e materialeve zgjedhore;
  - Shënimi i procedurave të votimit në protokolin e Komisionit Zgjedhor;
  - Vulosja e kutive të votimit dhe shënimi i numrave të vulave;
  - Shënimi i sasisë dhe numërimi i votave;
  - Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.

## Neni 23

Procedura zgjedhore duhet të përmbajë hapat si në vijim:

- Komisioni Zgjedhor kërkon nga votuesi të identifikojë vetveten me dokument të identifikimit (letënjoftim);
- Komisioni Zgjedhor kërkon nga votuesi që të identifikohet me një nga kategoritë e personelit;
- Komisioni Zgjedhor e gjen votuesin në listen e votuesve,
- Komisioni Zgjedhor kërkon nga votuesi të regjistrohet në listen e votuesve;
- Komisioni zgjedhor i jep votuesit fletëvotimet e përshtatshme;
- Votuesi fshehtazi shënon fletëvotimin në kabinën e votimit;
- Komisioni Zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë;
- Votuesi e hedhë votën në kutinë e votimit;
- Votuesi delë nga vendvotimi menjëherë pas votimit;
- Komisioni Zgjedhor shënon në protokol çdo ndryshim të këtyre procedurave.

S. D.

#### Neni 24

1. Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve të cilët janë regjistruar për mandat të caktuar. Kandidatët duhet të radhitën në fletëvotim sipas emrave dhe mbiemrave.
2. Secili votues ka të drejtë të shënojë aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një lajmërim i përshtatshëm duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.
3. Fletëvotimet janë valide kur maksimumi i kandidatëve të paracaktuar ose më pak - siç ceket në fletëvotim - janë shënuar dhe kur qëllimi i votuesit është i qartë.
4. Fletëvotimet janë jo-valide kur shënohen më shumë kandidat se sa maksimumi i paracaktuar - siç ceket në fletëvotim - ose kur nuk shënohet asnjë kandidat.
5. Në të gjitha rastet e tjera të kontestimit të validitetit të fletëvotimit, vendimi duhet të merret nga KQZ, sipas kërkesës së Komisionit Zgjedhor.

#### Neni 25

Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të dorëzojë ankesë në lidhje me procedurat e zgjedhjeve tek KQZ, një ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve. Formulari përkatës do të merret në KQZ.

### X. Rezultatet e zgjedhjeve - hedhja e shortit

#### Neni 26

1. Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të shpallë rezultatet preliminare të zgjedhjeve brenda 48 orëve pas mbylljes së vendvotimeve.
2. Shpallja e rezultateve përfundimtare bëhet nga KQZ brenda 5 ditëve nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njejtë të votave për një numër jo adekuat të mandateve në dispozicion, atëherë do të organizohet hedhja e shortit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor, që do të vendosë për ndarjen përfundimtare të mandateve.
4. Ky short duhet të organizohet brenda 48 orëve prej shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

S.A.

## XI. Periudha e ankesave

### Neni 27

1. Pas shpalljes zyrate të rezultateve preliminare shpallet një periudhë 48 orëshe për ankesa.
2. Gjatë kësaj periudhe mund të dorëzohen ankesa me shkrim në lidhje me procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe mandatarët.
3. Shqyrtimi i ankesave bëhet një ditë pas përfundimit të periudhës së ankesave.
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për detyrë të vendosë rreth të gjitha ankesave brenda periudhës së paraparë.
5. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet përfundimtare.

## XII. Dispozitat përfundimtare

### Neni 28

Dokumenti "Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UShAF" hynë në fuqi nga dita e miratimit në Këshill Drejtues.

### Neni 29

Me hyrjen të fuqi të Dokumentit "Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UShAF", shfuqizohet Dokumenti "Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UShAF", nr. 2601/19 dt. 26.07.2019.

Prof. As. Dr. Samet Dalipi

  
Kryesues i Këshillit Drejtues

